



KONTRATË DHURIMI

Sot më datë 04 Prill 2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë) ditën e Merkure, përpara meje Noteres së Dhomës së Noterisë Tiranë **Aida E. SHAMETI** me adresë në rrugën "Asim Vokshi", Kompleksi "USLUGA" u paraqitën personalisht palët kontraktuese:

DHURUESI: NERTIL SHTOJNAJ me atësi Zyber, lindur në Shkodër me 14. 08. 1987, me banim ne Tirane, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identitetin e te cilit e verifikova nga letërnjoftimi me numër personal I70814091T.

ANXHELA KASHARI me atësi Fatmir, lindur në Lushnjë me 22. 04. 1991, me banim ne Tirane, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identitetin e se cilës e verifikova nga letërnjoftimi me numër personal J15422028N.

Te mësipërmit me cilësinë e ortakëve të Shoqërisë "VISIONAL GRUP" SHPK.

PRANUES I DHURIMIT: LAURA KASHARI me atësi Fatmir, lindur në Lushnjë me 06. 04. 1987, me banim ne Tirane, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identitetin e se cilës e verifikova nga letërnjoftimi me numër personal I75406029P me cilësinë e ortakut të Shoqërisë "VISIONAL GRUP" SHPK.

Të mësipërmit me zotësi të plotë juridike për të vepruar të cilët me vullnetin e tyre të lirë më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate:

BAZA LIGJORE:

Kodi Civil, Neni 705 e vijues.

Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, neni 68 dhe 73 .

Vendimi Nr. 2 ortakëve të Shoqërisë "VISIONAL GRUP" SHPK datë 27. 03. 2018

OBJEKTI: Dhurimi i kuotës së ortakut të shoqërisë Nertil Shtojnaj pjesëmarrja e të cilit në kapitalin e shoqërisë sipas ekstraktit është 33 %, dhe i kuotes se Anxhela Kashari pjesëmarrja e së ciles në kapitalin e shoqërisë sipas ekstraktit është 34 % pranuesit të dhurimit ortakes tjetër Laura Kashari.

Shoqëria "VISIONAL GRUP" SHPK është krijuar si person juridik regjistruar në QKB, datë 23. 01. 2017 me seli në Tiranë, në adresën Tirane Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga Sheshi Ferdenc Nopcka, Nd. 6, H. 13. Ap. 14, me Nr. pasurie 1/232-N29 e përbërë nga tre ortakë përkatësisht Anxhela Kashari, Nertil Shtojnaj dhe Laura Kashari.

Bazuar në Vendimin Nr 2 datë 27. 03. 2018 të Ortakëve të Shoqërisë "VISIONAL GRUP" SHPK Z. Nertil Shtojnaj me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë e pa asnjë kusht kuotën e tij prej 33 % të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë në vlerën 33 lekë dhe Zj. Anxhela Kashari me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë e pa asnjë kusht kuotën e saj prej 34 % të pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë në

vlerën 34 lekë ja dhurojnë ortakës tjetër të Shoqërisë Laura Kashari e cila deklaron se e pranon këtë dhurim.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhurimi, dhuruesit Nertil Shtojnaj dhe Anxhela Kashari e humbasin çdo të drejtë pronësie mbi kuotën e tyre që përbëhet nga 67 % të kapitalit të shoqërisë me vlerë 67 lekë, në Shoqërinë "VISIONAL GRUP" SHPK dhe pronar i tyre bëhet Laura Kashari.

Me nënshkrimin dhe regjistrimin e kësaj kontrate Shoqëria "VISIONAL GRUP" SHPK do të ketë 1 ortak të vetëm përkatësisht Laura Kashari kuota e së cilës përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë në vlerën 100 leke.

Palët deklarojnë se morën dijeni për kryerjen e regjistrimit të këtij akti noterial në QKB Tiranë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Sa më sipër pasi u lexua nga palët në prani të Noteres, u konstatua se është sipas vullnetit të tyre të lirë dhe nënshkruhet pa asnjë vërejtje nga ana e tyre.

Kontrata, me kërkesën e palëve u hartua në katër ekzemplare, në dy faqe, në bazë të nenit 51 të ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë", nga të cilat një qëndron pranë kësaj zyre noteriale dhe tre të tjerat u jepën palëve.

Unë noterja pasi konstatova se akti i mësipërm është në pajtim të plotë me vullnetin e palëve dhe me ligjin e nënshkruaj rregullisht.

PALËT NE KONTRATE

Dhuruesit: Nertil Shtojnaj Pranuesi i dhurimit: Laura Kashari



NOTERE

Aida E. SHAMETI